770. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 334, dosje formulare nr. 5997, në ngarkim të D.E.B., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
771. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 334, dosje formulare nr. 5998, në ngarkim të O.S.T., me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
772. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 334, dosje formulare nr. 5999, në ngarkim të H.I.M., me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
773. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 334, dosje formulare nr. 6000, në ngarkim të Nj.M.H., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1947-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
774. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 334, dosje formulare nr. 6001, në ngarkim të I.N.D., me 367 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
775. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6002, në ngarkim të M.T.T., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
776. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6003, në ngarkim të N.Xh.S., me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1962-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
777. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6004, në ngarkim të A.N.T., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
778. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6005, në ngarkim të Ç.Q.Ç., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
779. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6006, në ngarkim të V.B.V., me 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1952-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
780. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6007/1, në ngarkim të Xh.S.N., me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1947-1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
781. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6007/2, në ngarkim të Xh.S.N., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1965-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
782. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6008, në ngarkim të J.A.N., me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1952-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
783. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6009, në ngarkim të I.S.K., me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
784. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6010, në ngarkim të H.M.S., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
785. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6011, në ngarkim të V.S.Ç., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
786. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6012, në ngarkim të F.J.K., me 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1952-1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
787. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6013, në ngarkim të V.H.C., me 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
788. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 335, dosje formulare nr. 6014, në ngarkim të K.Z.D., me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
789. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6015, në ngarkim të D.L.D., me 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
790. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6016, në ngarkim të Th.M.K., me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

791. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6017, në ngarkim të N.S.M./V., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
792. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6018, në ngarkim të A.K.K., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
793. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6019, në ngarkim të M.H.T., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
794. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6020, në ngarkim të H.B.I., me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
795. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6021, në ngarkim të R.I.R., me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
796. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6022, në ngarkim të O.S.M., me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
797. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6023, në ngarkim të H.F.H., me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
798. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6024, në ngarkim të M.A.M., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
799. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6025, në ngarkim të Q.E.Xh., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
800. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6026, në ngarkim të R.D.B., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
801. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6027, në ngarkim të F.R.H., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
802. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6028, në ngarkim të L.J.D., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
803. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6029, në ngarkim të H.H.C., me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
804. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje përpunimi nr. 6030, në ngarkim të M.R.H., me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1944-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
805. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 336, dosje formulare nr. 6031, në ngarkim të N.A.M., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
806. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje përpunimi nr. 6032, në ngarkim të S.M.L., me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
807. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare dhe dosje fashikull personale për të dënuar nr. 6033, në ngarkim të Sh.S.Gj., në total me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
808. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare dhe dosje pune nr. 6034, në ngarkim të H.L.L., në total me 94 (nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
809. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6035, në ngarkim të E.D.H., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
810. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6036/1, në ngarkim të R.A.F., me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1960-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
811. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6036/2, në ngarkim të R.A.F., me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1961. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
812. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6037, në ngarkim të B.H.A., me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1979-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
813. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6038, në ngarkim të V.I.K., me 44 (dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
814. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6039, në ngarkim të P.S.B., me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
815. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6040, në ngarkim të K.A.M., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
816. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6041, në ngarkim të I.K.B., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1960-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
817. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6042, në ngarkim të M.I.D., me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
818. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6043, në ngarkim të Q.M.Sh., me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
819. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6044, në ngarkim të A.H.R., me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
820. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6045, në ngarkim të G.M.M., me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
821. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6046, në ngarkim të M.Th.M., me 200 (dyqind) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

822. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6047, në ngarkim të M.N.B., me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1978-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
823. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6048, në ngarkim të K.S.Ç., me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1957. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
824. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6049, në ngarkim të J.A.M., me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1961-1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
825. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6050, në ngarkim të I.K.M., me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
826. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6051, në ngarkim të H.S.S., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1979-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
827. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6052, në ngarkim të F.M.C., me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1976-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
828. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6053, në ngarkim të M.Q.H., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
829. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6054, në ngarkim të K.S.S., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
830. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 337, dosje formulare nr. 6055, në ngarkim të R.Q.M., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
831. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6056, në ngarkim të F.I.K., me 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1961-1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
832. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6057, në ngarkim të H.V.D., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1967. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
833. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6058, në ngarkim të A.K.N., me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
834. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6059, në ngarkim të A.N.N., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1947-1951. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
835. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6060, në ngarkim të T./A.Dh.B., me 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
836. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6061, në ngarkim të Q.B.L., me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
837. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6062, në ngarkim të S.A.A., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
838. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6063, në ngarkim të P.M.Xh./M., me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1952-1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
839. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6064, në ngarkim të H.H.Sh., me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
840. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6065, në ngarkim të I.L.Sh., me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
841. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6066, në ngarkim të M.Z.M., me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
842. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6067, në ngarkim të D.S.M., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
843. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6068, në ngarkim të Dh.K.M., me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1970-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
844. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6069, në ngarkim të N.M.K., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1969-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
845. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6070, në ngarkim të M.L.S., me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1954-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
846. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 338, dosje formulare nr. 6071, në ngarkim të P.M.K., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
847. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 339, dosje formulare dhe dosje përpunimi nr. 6072, në ngarkim të R.L.B., në total me 424 (katërqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
848. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 339, dosje formulare nr. 6074, në ngarkim të N.Z.K., me 310 (treqind e dhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1972-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
849. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje formulare nr. 6076, në ngarkim të H.Sh.Sh., me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1948-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
850. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje formulare nr. 6077/1, në ngarkim të S.E.P., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1961-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
851. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje pune nr. 6077/2 "Busulla", në ngarkim të S.E.P., me 207 (dyqind e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1969-1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
852. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje pune nr. 6077/3, në ngarkim të S.E.P., me 258 (dyqind e pesëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

853. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje formulare, dosje fashikull personale për të dënuar dhe dosje personale me 2 volume nr. 6078 "Vjosa", në ngarkim të K.S.Xh., në total me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1979-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
854. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje personale me 2 volume nr. 6079 "Mali", në ngarkim të J.Th.M., në total me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
855. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje personale nr. 6080 "Inteligjenca", në ngarkim të K.A.R., me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
856. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje personale nr. 6081/1 "Ketri", në ngarkim të Dh.N.N., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
857. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 340, dosje pune nr. 6081/2 "Ketri", në ngarkim të Dh.N.N., me 212 (dyqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
858. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje personale nr. 6082 "Skiatori", në ngarkim të V.K.S., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
859. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje personale nr. 6083 "Pistoleta", në ngarkim të K.I.M., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
860. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6084, në ngarkim të M.H.K., me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
861. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6086, në ngarkim të A.Z.P., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
862. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6087, në ngarkim të E.B.I., me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1978-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
863. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje përpunimi nr. 6088, në ngarkim të O.I.H., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1979-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
864. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje përpunimi nr. 6089, në ngarkim të V.P.Ç., me 103 (njëqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
865. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6090, në ngarkim të S.T.L., me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
866. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6091, në ngarkim të F.E.N., me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
867. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6093, në ngarkim të R.S.B., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1948-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
868. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6094, në ngarkim të S.Th.T., me 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
869. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6096, në ngarkim të P.Z.B., me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
870. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje përpunimi nr. 6097, në ngarkim të M.D.L., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
871. Arkivi i Autoritetit, fondi operativ, kutia nr. 341, dosje formulare nr. 6098, në ngarkim të Z.G.G., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

KRYETARI I KDZH

Dr.Gentiana Sula



KUJTESA

DHE EDUKIMI QYTETAR

DITA E FITORES MBI NAZIZMIN DHE TOTALITARIZMIN AIDSSH EKSPOZITË DOKUMENTARE DHE DËSHMI PËR ARRATISJET DHE VRASJET NË KUFIRIN JUGLINDOR

TIRANË, 8 MAJ 2024



Në kuadër të 8 Majit, Ditës së Fitores mbi Nazizmin dhe Totalitarizmin AIDSSH-ja, me pjesëmarrjen e të prekurve nga arratisjet në kufi, studiuesve shkencorë, përfaqësuesve të pushtetit lokal, organizoi një ekspozitë me dokumente arkivore, me fakte nga ngjarje tragjike në rajonin kufitar të zonën juglindore të vendit: Kolonjë, Korçë, Pogradec, ku arratisjet kanë qenë të shumta e ku djem të rinj mbetën të vranë dhe të tjerë janë ende të pagjetur.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula u shpreh se: “Kërkesat për gjetjen e eshtrave të të vranëve në kufi, e drejta e publikut për t’u informuar mbi ngjarjet tragjike, ku vepra penale e arratisjes dënohej



me burg, me pasoja që përfshin dënimin dhe internimin e familjen, nxiti AIDSSH-në të nisë nga puna për hedhjen dritë mbi ngjarjet në kufi. Qëllimi përfundimtar i AIDSSH-së është realizimi e një memoriali në kujtim të jetëve të humbura dhe sakrificave njerëzore për liri.”

“Kemi kohë që e kemi të konceptuar dhe sa mirë që gjërat bëhen bashkë, për të ndërtuar atë që ne e kemi titulluar si “Shtegu i lirisë”, rrugën që një numër i lartë njerëzish kanë tentuar për tu arratisur, disa me sukses dhe disa fatalisht, të cilët patën të njëjtin vijimësi, duke i ndjekur pas vetes, përndjekja e tmerrshme familjare.” tha në fjalën e tij Kryetari i Bashkisë së Ersekës, z. Erion Isai.

Anëtari i Autoritet z. Gjergj Marku në fjalën e tij theksoi se: “Pas ndryshimeve në Kodin Penal, në 8 maj 1990, kalimi i paligjshëm i kufirit nuk konsiderohej me “tradhti ndaj atdheut”, por dënohej me 5 vite burg. Kjo i krijoi njerëzve një iluzion se nuk do të ndëshkoheshin me vdekje, por pikat kufitare nuk e zbatuan këtë vendim”.

Kryetari i Shoqatës Antikomuniste e Ish-të Përndjekurve Politikë, z.E'them Fezollari, rrëfeu për të pranishmit historinë e tij të arratisjes bashkë me familjen për në territorin jugosllav përmes liqenit të Pogradecit, duke lundruar me një varkë të bërë vetë.



Në ekspozitë u shpalosën 31 njësi dokumente arkivore me 3531 fletë, si: fonde hetimore-gjyqësore, historiket, indekset alfabetike të të arratisurve, regjistra për shkelësit e kufirit, listat e të arratisurve për vitet nga 1972 -1990 për tre zonat: Kolonjë, Korçë dhe Pogradec. Në analizë janë marrë edhe komunikatat ditore të DPB, ('49-'91), në 36042 faqe. Për të ashtuquajturit shkelësit e kufirit në zonën juglindore janë mbledhur të dhëna nga fondit nr. 142, i komunikatave ditore për periudhën 1978 -1991, me 13463 flete. Rreth 13. 600 persona u numëruan te arratisur ne raportet e Sigurimit te Shtetit, nga 1944 deri ne vitin 1990, pa llogaritur ato te ikur përmes ambasadave. Nga këta, rreth 4784 ishin gra dhe fëmije. Rreth 998 të tjerë vdiqën ose u vranë nga regjimi në këtë përpjekje.



AIDSSH MERR PJESË NË FORUMIN E KE-SË/ MOHIMI I FAKTEVE HISTORIKE DHE MANIPULIMI POLITIK

BOLONJË 15-16 MAJ 2024

“Në një kohë të prapambetjes demokratike, në një moment kur historia është e prirur për shtrembërim, duke përfshirë mohimin e disa fakteve historike dhe manipulimin politik, është thelbësore të sigurohen platforma për diskutime të hapura dhe produktive në lidhje me rolin e historisë në shekullin 21.”



Me këtë parim Këshilli i Evropës çeli forumin me temë: "Përforsimi i ndërgjegjësimit dhe kulturës historike përmes arsimit të lartë: kërcënimet dhe sfidat" ku morën pjesë 60 historianë nga Komiteti Drejtues i Arsimit (CDEDU), organizatat e doktoraturës dhe studentëve, institucionet dhe shoqatat e arsimit të lartë, historianët e specializuar në trajnimin e mësuesve të historisë dhe profesorët dhe drejtuesit e arsimit të lartë, organizata të rëndësishme në këtë fushë, si: Eurodoc, Unioni Evropian i Studentëve, Shoqata Ndërkombëtare e Universiteteve, Observatori Magna Charta.



E pranishme në këtë forum, Kryetarja e Autoritetit të Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit Shqipëri, Dr. Gentiana Sula, prezantoi studimin mbi "Identiteti dhe përgjegjësitë e historianëve në arsimin e lartë" duke u përqendruar në përvojën e AIDSSH-së, ndikimin e dhënies së aksesit publik në dokumentet historike, daljen në dritë të tregimeve të së kaluarës dhe tensionet që e shoqëruan këtë proces.

Më tej Dr. Gentiana Sula vijoi me vështrimin mbi filtrat e përdorur nga politika dhe kërcënimet ndaj lirisë akademike, sfidat për të njohur të shkuarën përmes qasjes në burime dhe mendimit kritik; ndarjen e akademisë nga mësimdhënia, si dhe përplasjen e narrativave mbi historinë e së shkuarës me ndikim në shoqëri. *“Historianët duhet të sfidojnë narrativat mbizotëruese dhe të eksplorojnë me tej në dokumentimin e historive të përndjekjes së grupeve të marginalizuara si një nevojë e domosdoshme për krijimin e një kulturë historike më gjithëpërfshirëse, duke ndezur dialogun mbi të shkuarën dhe edukimin historik të brezave rinj.”*, tha në përfundim të fjalës së saj, kryetarja e AIDSSH-së.

Forumi i Bolonjës u fokusua në kërcënimet dhe sfidat me të cilat përballet mësimi i historisë në institucionet e arsimit të lartë, i cili shpesh vihet në pikëpyetje apo edhe prerë në favor të lëndëve të tjera që duken më të lidhura me nevojat imediate të ekonomisë.

PUNA E INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2023

AIDSSH-JA RAPORTON NË KOMISIONIN PARLAMENTAR TË ÇËSHTJEVE LIGJORE

TIRANË, 21 MAJ 2024



Me një prezantim të dy botimeve, akademike dhe didaktike, mbi revoltën në kampin-burg të Spaçit, të burgosurve politikë, 21-23 maj 1973, nisi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportimi mbi veprimtarinë e AIDSSH-së gjatë vitit 2023. Autoriteti u përfaqësua nga kryetarja znj.Gentiana Sula dhe anëtarët z.Skënder Vrioni, z.Altin Hoxha, z.Albert Nikolla.

Kryetarja e AIDSSH-s Gentiana Sula e cilësoi fillimin e mandatit të dytë me arritje në konsolidimin institucional dhe legjislativ të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të

eshtrave të të zhdukurve dhe ekzekutuarve realizuar përmes hartimit të draft VKM dhe dërgimit në Ministrinë e Drejtësisë për dakordësi dhe miratim, hetimeve administrative në vendvarrimet e dyshuara, për rastet e vrasjeve në kufi, të zhdukurve gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit; për të zhdukurit në Shkodër.



Ajo theksoi gjithashtu edhe hartimin e databazës për personat e zhdukur gjatë kohës së komunizmit, shqyrtimit të 57 kërkesave, nga të cilat 39 rezultojnë me të dhëna arkivore, mbledhjen e informacioneve në lokacione si territori i burgut të Burrelit, burgu i Gjirokastrës, burgu i Shkodrës dhe Kampi i Tepelenës, zona e Spacit, etj.53 kërkesave drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Burgjeve, për gjetje të të dhënave për të pagjeturit. Kryerjen e kërkimeve në vende të dyshuara, për të cilat janë marrë edhe dëshmi, si në Mallkeq, Bashkia Selenicë, Shën Vasil, Bashkia Sarandë, fshati Vorfë, Njësia Administrative Gruemirë,

Bashkia Malësi e Madhe etj.

Raportimi vijoi me zbatimin e rezolutës së Kuvendit mbi veprimtarinë e Autoritetit; hartimin e akteve nënligjore në kuadër të përafrimit me ndryshimet që pësoi ligji nr. 45/2015 në vitin 2022, verifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie figure, pas ndryshimeve ligjore që sollën shfuqizimin e vendimeve të komisioneve “Bezhani” e “Mezini”,

Në vijim, relatori i seancës, z.Klevis Xhoxhi, pasi shprehu vlerësimin mbi punën e institucionit përgjatë vitit 2023, trajtoi me radhë pikat e rezolutës dhe punën e bërë për realizimin e tyre.

Pas paraqitjes së raportit, anëtarët iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve të Komisionit të Ligjeve sa i takon verifikimit të zyrtarëve, dhe efektit që ka pasur në këtë drejtim pas miratimit të ndryshimeve ligjore të vitit 2022 me shfuqizimin e komisioneve “Bezhani” e “Mezini.

Raporti i plotë: <https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>

PËRKUJTIMI DHE NARRATIVA E LIRISË AIDSSH MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN EVROPIAN TË KUJTESËS

VARSHAVË, 21-24 MAJ 2024



Ekspertë të AIDSSH morën pjesë në simpoziumin e 12-të Evropian të Kujtesës, në Muzeun Historik Polak në Varshavë. Tema e këtij viti ishte “Përkujtimi dhe narrativa e lirisë”, ku u theksua procesi i shkrimit dhe transmetimit të historisë në shkolla apo nëpërmjet mjeteve të tjera të edukimit.

Qëllimi i Simpoziomit Evropian të Kujtesës ishte shkëmbimi i përvojave dhe vendosja e metodave dhe formave të bashkëpunimit ndërmjet

institucioneve nga vende të ndryshme. Simpoziumi ka bashkuar përfaqësuesit e institucioneve historike evropiane në diskutimin mbi sfidat që lidhen me kujtesën dhe narracionin e diversifikuar dhe gjithëpërfshirës të së shkuarës.



Në ditën e parë të Simpoziomit, ndër të tjera, u trajtuan disa çështje me vlerë në kontekstin jo vetëm të aktivitetit të rrjetit ENRS, por edhe në fushën e historisë dhe konvergimit të saj me aspekte të tjera të jetës dhe veprimtarisë së shoqërisë, si politika dhe e drejta.

Secili prej pjesëmarrësve panelistë ndau përvojën e vendeve që përfaqësonin në lidhje me etapat nëpër të cilat ka kaluar procesi i shkrimit dhe i transmetimit të historisë, në shkolla apo nëpërmjet mjeteve të tjera të edukimit dhe komunikimit, si: arti, kultura, massmedia, duke i shërbyer të gjithë spektrit të grupeve sociale, politike, etnike, fetare dhe më gjerë. Një element thelbësor në ndërtimin e një narrative realiste dhe sa më të pranuar nga shoqëritë, rregullatore dhe programore efikase dhe që i shërbejnë të ardhmes, konsolidimit të demokracisë dhe mbi të gjitha arritjes së paqes sociale të shoqërive të traumatizuar nga lufta apo regjimet diktatoriale.

Një aspekt kyç me vlerë i këtij takimi ishte dhe pajtimi i plotë i pjesëmarrësve mbi rëndësinë që bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërorganizativ ka në tejkalimin e sfidave dhe përmbushjen e synimeve që kanë ENRS dhe shtetet pjesëmarrëse.

**PROMOVOHET LIBRI “DIELLI LIND NË SPAÇ”, BOTIMI PËR FËMIJË I AIDSSH-SË
GJURMË KUJTESE NË SPAÇ, TË RINJTË ‘PREKIN’ DIKTATURËN NË ISH- KAMPIN BURG
MIRDITË, 24 MAJ 2024**



Në kuadër të 51-vjetorit të Revoltës së Burgut të Spaçit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Këshillin e Europës, organizoi aktivitetin: “SPAÇI, DJE DHE SOT - një ditë kujtese me të rinjtë”, me pjesëmarrjen e 40 nxënësve dhe mësuesve të tyre të shkollës së mesme “At Shtjefën Gjeçovi”, Kurbin dhe shkollës 9 -vjeçare “Hamza Muça”, Shkallnuer, Durrës.



Kryetarja e Autoritetit, znj.Gentiana Sula, tha në fjalën e saj: “Fëmijët vijnë në këtë botë si të huaj, nuk dinë çfarë ka ndodhur, ndaj edhe ne vendosëm që krahas librit akademik për revoltën e Spaçit të gjejmë gjuhën e duhur për t’ia treguar historinë brezit të ri. Libri për fëmijë që prezantojmë sot përveç historisë së revoltës dhe konceptit mbi diktaturën, nëpërmjet rrëfimeve në vetë të parë të fëmijëve të ish-dënuarve, sjell si e përjetuan ata historinë, barrën e fajit të pakryer, veçimin shoqëror, stigmën që ata ndjenë gjatë jetës për shkak të burgosjes së baballarëve. Libri është shkruar nga shkrimtare për fëmijë dhe ka ilustrime grafike dhe sigurisht që ka kaluar në filtrin shkencor.”

“Sa herë që vij në Spaç përjetoj momente të forca emocionale për shkak të historisë që mbart ky kamp-burg. Fjala Spaç edhe nga goja e banorëve të zonës tingëllonte rrënqethëse dhe frikshme”, u shpreh Kryetari i i Bashkisë së Mirditës, z.Albert Mëlyshi.



Suela Kusi, përfaqësuese e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë në fjalën e saj tha se: “Ky vend na bashkon jo vetëm që të kujtojmë vuajtjet e të burgosurëve politikë gjatë regjimit komunist, por mbi të gjitha të diskutojmë mbi mësimet që mund të nxjerrim nga një prej periudhave me famëkeqe dhe komplekse të së kaluarës sonë komuniste.”

Rovena Rrozhani shkrimtarja e librit për fëmijë “Dielli lind në Spaç”, ndau me nxënësit përmbajtjen e librit duke i përfshirë ata gjatë tregimit të historisë. Libri është pasuruar me grafikën e artistes së artit vizual Anila Zajmi Katanolli.

Gjatë vizitës së tyre në Spaç nxënësit e të dyja shkollave zhvilluan një guidë në mjediset e mbetura të ish-kampit burg, ku mësuan më konkretisht për revoltën dhe mënyrën e jetesës të të dënuarve politikë. Ata e morën

informacionin nëpërmjet rrëfimit të ish-të dënuarit politik Agron Hoxha dhe mesazheve të fshehura në mjediset të ndryshme të ish-kampit, të cilat vetë nxënësit i zbuluan dhe i lexuan. Në këto mesazhe të fshehura, ishin shkruar copëza historie nga kampi, kujtime, poezi, dëshmi.

Grupi i të rinjve të shkollës së mesme u njoh me librin, "Spaç, historia e një revolte" dhe ndoqi dokumentarin me metrazh të shkurtër për të rinj "3 ditët e lirisë në Spaç". Ekspozita "Gjurmë qëndrese në Spaç", në përkujtim të 50-vjetorit të revoltës, si dhe ekspozita me punime artistike nga nxënës të shkollave të mesme artistike dhe Qendrës "Tumo", pasuruan njohuritë e fëmijëve. Katër pëllumba u lëshuan nga nxënësit në kujtim të katër të rinjve që u pushkatuan 24 majin e vitit 1973. Në një baner të posaçëm nxënës, mësues lanë gjurmën e tyre të kujtesës.

"Klubi i Librit-Mësojmë nga e kaluara" ndalon në Berat me librin e Drita Comos.



16-VJEÇARJA QË U PËRNDQOQ NGA 11 BASHKËPUNËTORË TË ISH- SIGURIMIT TË SHETIT

BERAT, 29 MAJ 2024

E kaluara e errët përmes dokumenteve arkivore të Ish-Sigurimit të Shtetit, dëshmime gojore, por edhe librave memuaristikë që sjellin ngjarje të treguara në vetën e parë nga të mbijetuar në kampe internimi



dhe burgjet komuniste ishte në fokus të "Klubi i Librit-Mësojmë nga e kaluara" i Beratit.

Mësues dhe nxënës e panë një pjesë të kësaj historie nga sytë e Drita Çomos, vajzës 16-vjeçare që u survejua nga 11 bashkëpunëtorë. Ajo la librin "Dritë që vjen nga humnera" ndërsa Sigurimi i Shtetit ka krijuar dokumente të cilat sot janë pjesë e arkivës së AIDSSH-së.

Aktiviteti u mbajt në Qendrën Multifunktionale Rinore, Berat ku ishin të pranishëm nxënës dhe mësues nga shkollat: "Riza Mulita", "Babë Dudë Karbunara", "Irfan Ngjeqari", "Drita e Dijes", si dhe përfaqësues të bashkisë e të zyrës vendore parauniversitare Berat.

Takimi u përshëndet nga kryetarja e AIDSSH-s. Gentiana Sula, e cila shpjegoi për nxënësit veprimtarinë e institucionit në informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe rëndësinë e njohjes së periudhës së komunizmit nga brezat e rinj. Dr. Edlir Orhani, specialist pranë AIDSSH shpjegoi mekanizmin e përndjekjes nga ish-Sigurimi i Shtetit dhe konkretisht përndjekjen e Drita Çomos. Ndërsa Elona Baçi, specialiste pranë AIDSSH-së bëri një përjasje të ditarit dhe dosjes. Fletë të ditarit u ballafaquan me dokumentet e gjetura në të cilat përkonin në data dhe ngjarje dhe drejtoi të gjithë diskutimin me të pranishmit.

Dr. Yzedin Hima, mësues i shkollës së mesme të përgjithshme jopublike "Irfan Ngjeqari", prezantoi temën "Drita Çomo, gjurmë drite mbi terr", shënime për librin

"Dritë që vjen nga humnera". Ndërsa nxënësit recituan poezi nga libri i Drita Çomos, si dhe paraqitën punime të realizuara prej tyre dedikuar temës së klubit.



ÇAMËRIA NË DOSJET E ISH- SIGURIMIT TË SHTETIT EKSPOZITË DOKUMENTARE DHE MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHOQATËN “ÇAMËRIA” TIRANË, 31 MAJ 2024



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit firmosi me Shoqatën Patriotike “Çamëria” një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e historisë dhe të ngjarjeve historike që lidhen me figurat e komunitetit çam të përndjekura nga regjimi komunist.

Nxjerrja e së vërtetës dhe njohja me të kaluarën, nëpërmjet ballafaqimit me dosjet, dokumentet dhe historitë e komunizmit i shërben sfidës për zhbërjen e narrativës së ngritur për këtë komunitet me tradita të moçme, i cili është ndodhur nën goditje të padrejta të historisë.

“Historia nuk është vetëm ajo që është shkruar në librat e historisë, por edhe ajo që ka mbetur në dosjet e arkivave, të panjohura dhe të papranuara për shumë vite. Të gjitha këto dokumente janë burime historike me rëndësi të madhe kombëtare, që zbardhin jo vetëm çështje identitare të komunitetit çam, por edhe zbulojnë të vërteta që ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.”, tha kryetarja e AIDSSH-së, Gentiana Sula.

Marrëveshja u nënshkrua me rastin e çeljes së ekspozitës arkivore "Çamëria në dosjet e Sigurimit", një aktivitet i mbajtur në kuadër të aktiviteteve të shoqatës nën siglën "80 vjet gjenocid".



AIDSSH ekspozoi dokumente nga tre fonde me një total prej 105 dosjesh nga fondi arkivor - Dega e Punëve të Brendshme Sarandë, Berat, Lushnjë, Elbasan, të arratisur etj., me 37 dosje formularë, fondi nr. 1, dosje hetimore-gjyqësore me 46 dosje dhe Drejtoria e I-rë e Sigurimit të Shtetit, fondi nr. 4 me 6 dosje. Dokumentet të tjera datojnë para Luftës së Dytë Botërore, përgjatë saj, dhe bëjnë fjalë për ngjarje të pazbardhura plotësisht ku evidentohen 20-25 mijë persona refugjatë çamë. Dokumentet evidentojnë edhe dëmet ekonomike, në banesa, në ekonomitë bujqësore, në makineri, në troje që ka pësuar ky komunitet.



**KALIMI I PALIGJSHËM I KUFIRIT DHE PASOJAT E TIJ NË REGJIMIN TOTALITAR
KREU I INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË SHKUP
VIZITON AIDSSH-NË**

TIRANË, 7 QERSHOR 2024




Kalimi i paligjshëm i kufirit dhe pasojat e tij janë çështje ndërshtetërore.

Përgjatë regjimeve totalitare në rajon, (1944-1991), shumë shqiptarë, këndej dhe andej kufirit, kanë hyrë dhe kanë dalë nga Shqipëria duke sakrifikuar edhe jetën. Qytetarët e Shqipërisë arratiseshin për shkak të dhunës së diktaturës, ndërsa shqiptarët e ish-Jugosllavisë prej dhunës dhe keqtrajtimit sistematik ndaj tyre, rrjedhojë e politikës antishqiptare.

Kryetarja e AIDSSH-s, Gentiana Sula dhe kryetari i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të

Shqiptarëve, në Shkup (ITSHKSH), Skënder Asani, u dakordësuan për shkëmbimin e inventarëve, dokumenteve, si dhe historive njerëzore me qëllim zbardhjen e fatit të shqiptarëve që kaluan kufirin drejt Maqedonisë, dhe anasjelltas, në zonën kufitare Ersekë- Korçë-Pogradec.

Dy institucionet synojnë aktivitete të përbashkëta që do të kontribuojnë në ndërtimin e narrativës që do t'i japë jetë projektit për ngritjen memorialit në fshatin Rehovë, Bashkia e Kolonjës, në kujtim të historive tragjike dhe sakrificave njerëzore për liri.



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidosjeve.gov.al>